

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pas dronit në aeroport, Gjermania me strategji të re kundër sabotimeve
ADRESA	https://indeksonline.net/pas-dronit-ne-aeroport-gjermania-me-strategji-te-re-kunder-sabotimeve/
BURIMI	indeksonline.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 16:40:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 16:33:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6be678543cb9a179e8671e6efad4ab5aad65a64a6035e9fa798fb1ec13aa9601
TEKSTI	c33eb5e7cef5df5984dac1f781a85c49633fcb4d401d2c11c98a9f889f0c1bfe
PAMJA	e551aae8c7d593f688461f57a596525d43be53c11f1131537cf1b17a206bbe21

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	71a4c0059b66bbae0c554a1ccaee258c1d040865c0d85fbcef578bb04f5760e7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	68b473e302cc781fa81a9fb6ddcb464cf9103c6ca61b277406c21d5dd6bba777
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/71a4c0059b66bbae0c554a1ccaee258c1d040865c0d85fbcef578bb04f5760e7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Ballina](#)
- [Lajme](#)
- [Sport](#)
- [Showbiz](#)
- [Tech](#)
- [Auto](#)
- [Kuriozitete](#)
- [Indeks+](#)
- [Ekonomi](#)
- [Shëndetësi](#)
- [Zgjedhjet](#)
- [Opinion](#)



Kërko produktin...





SHPËRINDAJE








18:33 / E Diele, 06 Shtator 2026 / F.R

Pas dronit në aeroport, Gjermania me strategji të re kundër sabotimeve



Gjermania po planifikon krijimin e një “mburoje mbrojtëse” për të parandaluar dhe luftuar përpjekjet për sabotim, pas incidentit me një dron në aeroportin Leipzig/Halle në gusht, raporton gazeta gjermane *Bild*.

Ministri i Brendshëm gjerman, Alexander Dobrindt, tha për *Bild* se sulmet hibride ruse janë bërë “realitet i përditshëm” dhe se ato pritet të shtohen, por theksoi se Gjermania ka mundësi për t’u mbrojtur.

Sipas planit të ri, do të krijohet një “Cyberdome”, një rrjet sensorësh digjitalë që do të ndihmojë në zbulimin dhe pengimin e përpjekjeve për sulme kibernetike.

Gjermania planifikon gjithashtu të zgjerojë kapacitetet e policisë për mbrojtjen nga dronët. Njësi të lëvizshme, të afta për t’u dislokuar me shpejtësi, pritet të vendosen në qytete të mëdha si Berlini, Mynihu dhe Hamburgu, me qëllim mbrojtjen e hapësirës ajrore mbi qendrat kryesore të transportit.

Plani parasheh edhe përdorim më të gjerë të inteligjencës artificiale dhe teknologjisë së njohjes së fytyrës për identifikimin e personave të dyshuar për sulme. Ndërkohë, kompanive do t’u jepet e drejta për të zbuluar dronët dhe për të ndërmarrë masa aktive kundër tyre.

Çfarë ndodhi në Leipzig?

Masa e re vjen pas incidentit të 4 gushtit, kur një dron i pajisur me eksplozivë u gjet në aeroportin Leipzig/Halle, një prej qendrave të rëndësishme të transportit të mallrave në Gjermani.

Pas incidentit, pistat e aeroportit u mbyllën përkohësisht, ndërsa disa fluturime u devijuan.

Qeveria gjermane më pas e akuzoi zyrtarisht Rusinë për sulmin e dyshuar. Ministri i Jashtëm Johann Wadepuhl njoftoi masa ndaj Moskës, përfshirë mbylljen e konsullatës së Rusisë në Bon dhe të qendrës kulturore ruse në Berlin.

Rusia i ka mohuar akuzat, duke i cilësuar ato si “të pabazuara” dhe “absurde”. Ambasadori rus në Gjermani, Sergey Nechayev, paralajmëroi se masat gjermane përfaqësojnë një përshkallëzim të paprecedentë të marrëdhënieve mes dy vendeve dhe se “nuk do të mbeten pa pasoja”.

Ndërkohë, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka shprehur “solidaritët të plotë” me Gjermaninë, duke thënë se sulmi i dyshuar ishte kryer me materiale të nivelit ushtarak dhe nga operativë rusë në territorin e Bashkimit Evropian.

- [Një veturë e FSK-së përfshihet në një aksident trafiku në kryeqytet \(Foto\)](#)



- [“Ndryshoi jetën time”, ushtari i KFOR-it kujton momentin e hyrjes në Kosovë 25 vjet më parë](#)



- [“I ke 30 minuta... Koha po kalon, kanë mbetur dhe 28 minuta”/ Kush është komandanti gjerman, që i dëboi nga Prizreni ushtarët serbë?](#)



- [Shoferi i dehur gjobitet 2 herë, brenda pak minutash, për tejkalim shpejtësie](#)

- [Hajdari: Roli i Avokatit të Popullit të mos involvohet në procedura gjyqësore](#)

- [AKB: Rreth 40 për qind të bizneseve s'e përdorin arkën fiskale në mënyrën e duhur](#)

- [Aksidenti i rëndë në autostradën "Ibrahim Rugova", të lënduarve po iu ofrohet ndihma mjekësore](#)



Të fundit nga Indeks+

- [20:45 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Djali i Joe Bidenit bëri shaka se do të kandidonte vetëm nëse i kthehej drogës, tani nuk e përjashton mundësinë](#)
- [17:34 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Mbijetoi 10 ditë nën rrënoja, grua ja nxirret e gjallë në Nepal](#)
- [16:16 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Ish-sekretari amerikan i Mbrojtjes: Lufta SHBA-Iran mund të zgjasë edhe gjashtë muaj](#)
- [10:29 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Irani thotë se është kundërpërgjigjur pas sulmeve amerikane](#)
- [08:18 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Witkoff dhe Kushner pas takimit me Putinin në Moskë, udhëtojnë për në Kiev](#)
- [19:30 / E Shtunë, 05 Shtator](#)
[Putin urdhëron armëpushim 3-ditor në Kiev](#)

TEL Redaksia: +383 (0) 48 36 36 39 | Marketing: +383 (0) 49 686 666 **EMAIL** info@indeksonline.net | marketing@indeksonline.net [Indeksonline.net](https://indeksonline.net)



Portali Indeksonline u themelua nga një grup gazetarësh kosovarë në vitin 2010. Përball sfidave të gazetarisë bashkëkohore, të motivuar nga nevoja për lajme të shpejta dhe origjinale, në Kosovë, ndër shqiptarë dhe për shqiptarët – Indeksonline nuk ishte veçse një kërkesë e kohës.

Materialet dhe informacionet mund të kopjohen, të shtypen dhe të përdoren por vetëm pas referimit të qartë të burimit të Portalit Indeksonline, në përputhje me kushtet e përdorimit.!!

© 2010 - 2026 Portali Indeksonline. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.